

Togfjalëshi

Njohuri të përgjithshme për togfjalëshin

Togfjalëshi është njësi më e vogël sintaksore në të cilën realizohet mundësia e fjalëve për t'u bashkuar me njëra-tjetrën.

Në fjalinë: *Kënga e bukur popullore do të trashëgohet në përjetësi nga brezat e shqiptarëve*, dallojmë këta togfjalësha: *kënga e bukur; kënga popullore, do të trashëgohet në përjetësi; do të trashëgohet nga brezat; nga brezat e shqiptarëve*.

Togfjalëshi është njësi sintaksore strukturore e përfituar gjatë ligjërimit nga bashkimi gramatikor dhe kuptimor i dy ose më shumë fjalëve kuptimplota (shënjuese), të bashkuara me lidhjen e nënrenditjes, që tregon marrëdhënie midis sendeve, dukurive, proceseve e tipareve. Është një tog që përbëhet të paktën prej dy fjalësh kuptimplota. (Siç dihet fjalët kuptimplota janë: *emri, mbiemri, numërori, përemri, folja, ndajfolja*, kurse fjalët shërbyese janë: *parafjalët, lidhëzat, nyjat* etj.). Nuk kemi togfjalësha të tipit: *në shkollë, pranë meje, si luan, i shtëpisë* etj.

Togfjalëshat *këndon bukur, flamur i kuq, ky djalë, ajo shkollë* etj. janë togfjalësha të lirë, që i studion sintaksa. Ka edhe togfjalësha të qëndrueshëm të cilët nuk janë objekt i sintaksës: *iu bë zemra mal, vë re, i bëj ballë, Biblioteka Kombëtare*, etj.

Ndërtimi e togfjalëshit

Në gjuhën shqipe çdo togfjalësh përbëhet gjithmonë prej dy gjymtyrësh: prej *gjymtyrës kryesore* dhe *gjymtyrës së varur*: *Atdheu ynë, qielli i kaltër, shkruaj me laps, kjo shkollë* etj.

Nga pikëpamja e ndërtimit në gjuhën shqipe togfjalëshat janë dy llojesh: *të thjeshtë*: libër i bukur; klasa jonë; dhe *të zgjeruar*: *leximi i këtij libri, librin e këtij shkrimtari*.

Marrëdhëniet kuptimore ndërmjet gjymtyrëve në togfjalësh

Ndërmjet gjymtyrëve në togfjalësh vendosen këto marrëdhënie kuptimore:

- **marrëdhënie përcaktore**: *pylli i gjelbër; bukë gruri; shirat e vjeshtës; djalë me vullnet; ky student*.
- **marrëdhëniekundrinore**: *dëgjoj muzikë, pres trenin, takoj shokun, bisedoj me të, etj.*
- **marrëdhënie rrethanore**: *kohore, mënyrore, vendore*, etj. Do të vij nesër, shkruaj bukur, vij nga Tirana.

- **marrëdhënie predikative** janë ato që vendosen ndërmjet kryefjalës dhe kallëzuesit: *traktori lëron, nxënësi mëson, qielli nxihet*, etj.

Lidhjet gramatikore ndërmjet fjalëve në togfjalësh

Fjalët në togfjalësha bashkohen sipas tre lloj lidhjesh nënrenditjeje sintaksore, që janë: *lidhja e përshtatjes, lidhja e drejtimit dhe lidhja e bashkimit*.

- **Përshtatje** quhet lidhja kur gjymtyra e varur përshtatet me kryesoren në *gjini, numër, rasë*:
Bari i gjelbër ndriste nën rrezet e vakëta të diellit mëngjesor..

- **Drejtim** quhet ajo lidhje nënrenditëse ku fjala e varur vihet në një trajtë rasore të caktuar siç e këkon natyra leksikore e fjalës kryesore, si: *lexoj librin; zhvillimi i ekonomisë, lule mali*.

- **Bashkimi** është ajo lidhje nënrenditëse ku fjala e varur lidhet me kryesoren me pranëvënie, d.m.th., fjala e varur është e pandryshueshme nga forma: *punon mirë, iku larg, mësoj duke punuar, pesë lule, çdo shkollë; asnjë student*;

Klasifikimi i togfjalëshave

Togfjalëshat klasifikohen duke marrë për bazë kategorinë leksikogramatikore të fjalës kryesore. Kështu kemi:

- **togfjalëshat emërorë** si gjymtyrë kryesore kanë një emër: *këngë trimash, rrugë me kalldrëm, student i sjellshëm, njeri fisnik, dëshira për të lexuar, ky libër, dy fletore, kati lart, valle burrash, përralla për fëmijë*.

- **togfjalëshat foljorë**: *laj duart, shkruaj një poezi, nuk trembem nga vështirësitë, luftojmë për demokraci, u nis për të takuar*.

- **togfjalëshat mbiemërorë**: *i ri nga mosha, i talentuar në muzikë, e sjellshme me shoqet, pak i kripur, shumë i madh, i pafuqishëm për të ecur*.

- **togfjalëshat përemërorë**: *secili prej nesh, dikush nga ju*.

- **togfjalëshat ndajfoljorë**: *mjaft mirë, shumë lart, mjaft vonë*.